




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E EKONOMISË ,KULTURES DHE INOVACIONIT
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Fier**

Nr 327 Prot

Fier më, 10.09.2025

Lënda: Njoftim për Levizje paralele .

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHENIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.**

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” ; të ligjit nr 15/2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive “ ; të udhëzimit Nr 759 datë 30.09.2024 “ Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarisë menaxhimit te burimeve ,përberës së njesisë së zhvillimit të institucioneve ,ofruesve te arsimit dhe formimit professional dhe zhvillimit të vazhdueshem professional të personelit ” , *inshty shuar*.

Ofruesi i AFP_së, Qendra e Formimit Profesional Publik Fier , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin me kohe te pjeseshme :

- instruktor i praktikës profesionale ne kursin Aftesi Digjitale (Berat)1 person
- instruktor i praktikës profesionale ne kursin Kuzhine IEVP (Berat)1 person
- instruktor i praktikës profesionale ne kursin Instalim dhe Mirembajtje e Rrjetit Elektrik IEVP (Berat)1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryejë detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostroj aftësi te punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a)Të ketë te paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale , pas te mesme ose

parauniversitare në të njejtnë fushë me kualifikimin /kualifikimet profesionale për të cilin po aplikon .

b)Të ketë të paktën 3(vjet) përvojë pune në fushën në të cilën ka kryer studimet :

c)Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit .

2.Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë , duhet të përfshijë.

a)letërmotivimin për pozicionin:

b)jetëshkrimin (CV-në)

c)kartën e indentitetit

d)diplomë/deftese e shkollës së mesme

e)libreza e punës

f)çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim CV;

g)çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h)vërtetim i gjëndjes shëndetësore

i)vërtetimin e gjëndjes gjyqësore

j)vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi

k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre ; Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofrimit të AFP-së brenda datës. 19.08.2025

DREJTOR

Odeta KULLA

